




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATË/A:	19.08.2015
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Ismet HYSENI Udhëheqës i Prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë
CC:	z. Gani SHABANI Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull "Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga L.E"

Të nderuar,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 të Ligjit nr. C3/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me "Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga L.E" me numër prokurimi: 206 15 015 111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Ministria e Shëndetësisë si Autoritet Kontraktues me datë 03.08.2015 përmes zyrës së prokurimit ka paraqitur kërkesën zyrtare përmes postës elektronike në Agjencinë kundër Korrupsionit, përmes të cilës ka kërkuar që ndonjë përfaqësues nga Agjencia kundër Korrupsionit të jetë pjesë e Monitorimit lidhur me vlerësimin e tenderit me titull "Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga L.E" me numër Prokurimi: 206 15 015 111.

Aktivitet i prokurimit ne faqen elektronike te KRPP-se është publikuar me datën 16.07.2015 në procedurë të hapur, ndërsa tek neni II pika 1.9 te njoftimit për kontratë informohemi se ky tender është ndare në katër pjesë. Autoriteti Kontraktues/ Departamenti i prokurimit në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë i ka specifiku qarte të gjitha kërkesat minimale për kualifikim (përshtatshmëria, profesionaliteti, kërkesat teknike dhe financiare) si dhe kriteret për dhënie të kontratës te cilat janë përpiluar ne pajtueshmëri me LPP dhe ligjet qe e rregullojnë specifikën e prokurimit për këtë tender referuar ne. Ligji 04/L-190 – për produkte dhe pajisje medicinale dhe Udhëzimit Administrativ 1/2015 për Autorizimin për Marketing.

Objekti i kësaj kontrate është i ndarë në dy pjesë:

Ku për **Lot 9** kemi furnizim me Analog insulinë me veprim të shpejtë, për **lot 10** kemi furnizim me Insulinë me veprim të shkurtër, insulinë e tretshme, për **lot 11** furnizim me Insulinë bifazike isophane 25-30/70-75 (insulinë e tretshme 25%-30% + insulinë isophane 70% - 75%), dhe për **lot 12** furnizim me insulinë me veprim të ndërmjetëm insulinë isophane.

Ky aktivitet i prokurimit ka qene i planifikuar dhe vlera e parashikuar arrin deri ne 1,000,000.00 (€) pas vlerësimit formal te nevojave te bërë nga departamenti i farmacisë për këto dy produkte konkretisht këto kërkesa përfshihen ne shkresën zyrtare te njësisë kërkuese.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit Operatori Ekonomikë Buçaj SH.P.K më datë 30.07.2015 ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të prokurimit për shqyrtimin e lëndës “Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga L.E” –Ritender, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Ministria e Shëndetësisë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit më datë 10.08.2015 përmes një AKT PËRCJELLËS njofton Menaxherin e Prokurimit-MSH me raportin e ekspertizës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga L.E” –Ritender. Sipas raportit të ekspertit shqyrtues Autoriteti Kontraktues është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë procedurë të prokurimit dhe pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojë sipas nenit 115 të LLP-së. Eksperti shqyrtues bazuar në sqarimet e cekura në raport mendon se Autoriteti Kontraktues- Ministria e Shëndetësisë, për aktivitetin e prokurimit: “furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga L.E” me nr. Të Prokurimit 206 15 015 111 – Ritender, i ka respektuar në përgjithësi dispozitat e LPP-së.

Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta aprovoj vendimin e AK-së, njoftimin për kontratë, gjithashtu eksperti shqyrtues rekomandon panelin shqyrtues që ta refuzoj ankesën e OE “Buçaj”shpk, si të pabazuar.

Për të njëjtin aktivitet të prokurimit është parashtruar edhe ankesa me nr280/15 e datës 29.07.2015, mirëpo për të njëjtën ankesë më datë 03.08.2015, është parashtruar kërkesë në OSHP, për tërheqje nga ankesa ndërsa më datë 05.08.2015, OSHP nxjerr Konkluzion mbi aprovimin e kërkesës për tërheqje të ankesë. Po ashtu me datë 17.08.2015 përmes një Njoftimi OSHP e autorizon Autoritetin Kontraktues- Ministrinë e Shëndetësisë që të vazhdoj me tutje me procedurën e prokurimit konform dispozitave të LLP-së, ndërsa ankesa e operatorit ekonomik

ankues "Buçaj" sh.p.k do të shqyrtohet në procedurë të rregullt pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka marr pjesë në cilësinë e monitoruesit në vlerësimin e tenderëve dhe ka shqyrtuar me kujdes të gjitha dokumentet e tenderit me titull "Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga L.E" ka konstatuar të dhënat si në vijim:

Për këtë aktivitet të prokurimit dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 13 Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar vetëm 5 OE.

AKK ka konstatuar se për lot 9 kanë ofertuar 4 Operatorë ekonomik ku 3 prej tyre që kanë tenderuar për këtë lot janë të përgjegjshëm, ndërsa njëri nuk është i të përgjegjshëm pasi që nuk ka përmbushur të gjitha kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit nga ana e autoritetit kontraktues.

Lidhur me Lot 10 AKK ka konstatuar se për këtë lot kanë tenderuar tre Operator Ekonomik ku dy nga këta janë të përgjegjshëm, ndërsa njëri prej tyre nuk është i përgjegjshëm pasi që nuk i përmbush të gjitha kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Edhe për Lot 11 Agjencia ka konstatuar se për këtë lot kanë tenderuar katër Operatorë Ekonomik ku 2 prej tyre që kanë tenderuar për këtë lot janë të përgjegjshëm, ndërsa 2 prej tyre nuk janë të përgjegjshëm pasi që nuk i përmbushin të gjitha kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Ndërsa për Lot 12 nga agjencia është konstatuar se për këtë lot ofertat e tyre i kanë dorëzuar tre OE. ku 2 prej tyre që kanë tenderuar për këtë lot janë të përgjegjshëm, ndërsa njëri prej tyre nuk është i përgjegjshëm pasi që nuk i përmbush të gjitha kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar dhe ekzaminuar me kujdes dokumentacionin e ofruar lidhur me këtë procedurë të prokurimit, dhe pas monitorimit që ka bërë në vlerësimin e këtij tenderit nuk ka gjetur prova të mjaftueshme me të cilat do të evidentohet ndonjë shkelje e dispozitave të LPP-së.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr.03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt !